



Urdhri i Punonjësve Socialë

KODI I ETIKËS DHE DEONTOLOGJISË I PUNONJËSVE SOCIALË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Tabela e përmbajtjes

Parathënie

Qëllimi i Kodit

Parimet etike

Ofrimi i shërbimit

Promovim i Drejtësisë Sociale

Respektimi i Dinjitetit dhe Vlerave njerëzore

Rëndësia e Marrëdhënieve Njerëzore

Integriteti

Kompetenca

Standartet etike

Kreu 1-Përgjegjësitë Etike të Punonjësve Socialë ndaj Klientëve

1.01 Përkushtimi ndaj klientëve

1.02 Vetëvendosja

1.03 Miratimi i Informuar

1.04 Kompetencat/Aftësitë dhe shprehjet

1.05 Kompetencat/Aftësitë dhe shprehjet Kulturore dhe Diversiteti Social

1.06 Konflikti i Interesave

1.07 Privatësia dhe Konfidencialiteti

1.08 E drejta mbi Dosjet

1.09 Marrëdhëniet Seksuale

1.10 Kontakti Fizik

1.11 Ngacmimi Seksual

1.12 Të Folurit Fyës

1.13 Pagesa për Shërbimet

1.14 Klientët të Cilëve u Mungon Aftësia për Vendim-marrje

1.15 Ndërprerja e Shërbimeve

1.16 Përfundimi i Shërbimeve

KREU 2-Përgjegjësitë Etike të Punonjësve Socialë ndaj Kolegëve

2.01. Respekti

2.02. Konfidencialiteti

2.03 Marrëdhëniet ndërdisiplinore

2.04 Mosmarrëveshjet midis kolegëve

2.05 Konsultimi

2.06 Referimi për shërbimet

2.07 Marrëdhëniet seksuale

2.08 Ngacmimet seksuale

2.09 Dëmtimi i kolegëve

2.10 Paaftësia profesionale e kolegëve

2.11 Sjellja joetike e kolegëve

KREU 3-Përgjegjësitë Etike të Punonjësve Socialë në Praktikë

3.01 Supervizimi dhe Konsultimi

- 3.02 Trajnimi dhe Edukimi
- 3.03 Vlerësimi i punës
- 3.04 Regjistrimi i të dhënave për klientin.
- 3.05 Kontrata e shërbimeve
- 3.06 Transferimi i Klientit
- 3.07 Administrimi
- 3.08 Edukimi dhe Zhvillimi i Mëtejshëm i Stafit
- 3.09 Detyrimet ndaj punëdhënësve
- 3.10 Mosmarrëveshjet në menaxhimin e punës.

KREU 4-Përgjegjësitë Etike të Punonjësve Socialë si Profesionistë

- 4.01 Kompetencat/aftësië dhe shprehinë
- 4.02 Diskriminimi
- 4.03 Sjellja personale
- 4.04 Mashtrimi dhe Pandershmëria
- 4.05 Pengesat apo Vështirësitë
- 4.06 Përfaqësimi dhe prezantimi
- 4.07 Tërheqja
- 4.08 Pranimi i Meritave

KREU 5-Përgjegjësitë Etike të Punonjësve Socialë ndaj Profesionit të Punës Sociale

- 5.01 Integriteti i Profesionit
- 5.02 Vlerësimi dhe Kërkimi

KREU 6-Përgjegjësitë Etike të Punonjësve Socialë ndaj Shoqërisë në Tërësi

- 6.01 Mirëqenia Sociale
- 6.02 Pjesëmarrja Publike
- 6.03 Emergjencat Publike
- 6.04 Veprimi Social dhe Politik

Parathënie

Puna sociale është veprimtaria profesionale e bazuar te praktika, si dhe një disiplinë akademike që promovon ndryshimin, zhvillimin, kohezionin social dhe drejtësinë sociale, si dhe fuqizimin dhe pavarësimin e njerëzve. Misioni i profesionit të Punës Sociale është të përmirësojë mirëqenien e popullsisë dhe të ndihmojë në plotësimin e nevojave bazë të të gjithë njerëzve, duke i kushtuar vëmendje të veçantë nevojave dhe fuqizimit të personave që përballen me probleme të mbijetesës, që janë viktima të dhunës apo shfrytëzimit dhe që rrezikojnë të mbeten në ciklin e përjashtimit ekonomik dhe social. Një tipar karakteristik dhe përcaktues i Punës Sociale është fokusi i dyfishtë i profesionit si tek mirëqenia e individit brenda kontekstit social, ashtu edhe tek mirëqenia në tërësi e shoqërisë. Është shumë e rëndësishme që Puna Sociale t'i kushtojë vëmendje të veçantë forcave të mjedisit të cilat shkaktojnë apo zbusin problemet e jetesës.

Punonjësit socialë promovojnë drejtësinë sociale dhe ndryshimin social në emër të klientëve. Termi “Klient” përdoret posaçërisht për t’iu referuar individëve, familjeve, grupeve, organizatave dhe komuniteteve që përfitojnë nga shërbimet e punonjësve socialë. Punonjësit socialë janë të ndjeshëm ndaj diversitetit etnik-kulturor, e luftojnë për t’i dhënë fund përjashtimit social, varfërisë dhe formave të tjera të padrejtësisë sociale. Këto aktivitete mund të realizohen nëpërmjet praktikës direkte, organizimit të komunitetit, supervizionit, konsultimit, administrimit, advokacisë, veprimit social dhe politik, zhvillimit dhe zbatimit të politikave sociale, këshillimit, edukimit, kërkimit, dhe vlerësimit. Punonjësit socialë synojnë të pasurojnë kapacitetin e njerëzve për të plotësuar vetë nevojat e tyre, si dhe të nxisin organizata, komunitete, dhe institucione të tjera sociale për t’iu përgjigjur nevojave dhe problemeve sociale që përjeton individit.

Misioni i profesionit të Punës Sociale i ka rrënjët në një tërësi vlerash bazë. Këto vlera qendrore që janë edhe guri themelor i qëllimit dhe i perspektivës së Punës Sociale përfshijnë:

- Ofrim shërbimi
- Promovim i drejtësisë sociale
- Respektim i dinjitetit dhe vlerave njerëzore
- rëndësia e marrëdhënieve njerëzore
- integritet
- kompetencë

Kjo tërësi vlerash themelore pasqyron atë që është unike në profesionin e punonjësit social. Vlerat bazë dhe parimet që rrjedhin nga to, duhet të balancohen brenda kontekstit dhe kompleksitetit së eksperiencës njerëzore.

Qëllimi i Kodit Etik

Etika profesionale është në qendër të Punës Sociale. Profesionit ka për detyrë të artikulojë vlerat e tij bazë, parimet, dhe standardet etike. Kodi Etik i përcakton këto vlera, parime dhe standarde me qëllim që të udhëheqë sjelljen profesionale të punonjësit social.

Kodi vlen për të gjithë punonjësit socialë dhe studentët e Punës Sociale, pavarësisht nga funksionet e tyre profesionale, vendi i punës, apo popullata së cilës i shërbejnë.

Kodi Etik ka gjashtë qëllime kryesore:

1. Kodi identifikon vlerat bazë mbi të cilat mbështetet misioni i Punës Sociale.
2. Kodi përmbledh parimet etike që pasqyrojnë vlerat themelore të profesionit si dhe përcakton një tërësi standardesh specifike që udhëheqin praktikën e punonjësit social.
3. Kodi ndihmon punonjësit socialë të zgjidhin konflikte lidhur me detyrime profesionale apo me paqartësi etike.
4. Kodi siguron standarde etike mbi të cilat publiku i gjerë mund ta konsiderojë Punën Sociale një profesion të mirëfilltë.
5. Kodi i njeh praktikantët e rinj në fushën e Punës Sociale me misionin, vlerat, parimet dhe standardet etike të profesionit.
6. Kodi përcakton standarde që vetë profesionit i Punës Sociale mund t'i përdorë për vlerësimin e një sjellje joetike nga ana e punonjësve socialë.

Urdhëri i Punonjësve Socialë Shoqata Kombëtare e Punonjësve Socialë mbështetet në procedura formale për të gjykuar mbi ankimet për çështje etike ndaj anëtarëve të saj. Me pranimin e Kodit, punonjësve socialë u kërkohet të bashkëveprojnë në zbatimin e tij, të marrin pjesë në procedurat e gjykimit të Urdhërit dhe t'i përmbahen rregullave disiplinore apo sanksioneve të bazuara në të.

Kodi ofron një tërësi vlerash, parimesh dhe standardesh, të cilat udhëheqin vendim-marrjen dhe sjelljen profesionale në rastin kur diskutohen çështje etike. Ai nuk ofron një tërësi rregullash, të cilat paracaktjnë sjelljen e punonjësve socialë në të gjitha situatat. Aplikimet specifike të Kodit duhet të realizohen duke patur parasysh si kontekstin gjatë të cilit ky Kod po merret në konsideratë, ashtu edhe mundësinë e rënies në konflikt mes vetë vlerave, parimeve dhe standardeve të Kodit. Përgjegjësitë etike rrjedhin nga marrëdhëniet njerëzore, personale, familjare, sociale dhe ato profesionale, karakteristike për mjedisin ku është në diskutim sjellja profesionale.

Me tej, Kodi Etik nuk specifikon se cilat vlera, parime dhe standarde janë më të rëndësishme dhe duhen vlerësuar më tepër në rast se ka konflikt mes tyre. Vendim-marrja etike në një situatë të caktuar duhet të përfshijë gjykimin individual të punonjësit social dhe gjithashtu duhet të marrë në konsideratë mënyrën sesi çështjet do të ishin gjykuar nga një grup profesionistësh në një proces ku do të vlerësoheshin standardet etike të profesionit të aplikuar në këtë situatë.

Vendim-marrja etike është një proces. Ka shumë raste në Punë Sociale kur përgjigje të thjeshta nuk ndihmojnë në zgjidhjen e çështjeve komplekse etike. Punonjësit socialë duhet t'i kenë parasysh të gjitha vlerat, parimet dhe standardet e Kodit Etik, që janë të

rëndësishme për situatën gjatë së cilës kërkohet gjykim etik. Vendimet dhe veprimet e punonjësve socialë duhet t'i përmbahen frymës dhe mesazhit që përcjell ky Kod.

Përveç Kodit, ka edhe shumë burime të tjera të vlefshme informacioni lidhur me të menduarin etik. Punonjësit socialë duhet të njohin në tërësi teoritë dhe parimet etike, teorinë dhe studimet në Punë Sociale, ligjet, rregullat, politikat e agjencisë, dhe kode të tjera etike dhe më tej të zgjedhin si burim kryesor Kodin në fjalë. Punonjësit socialë duhet të jenë të ndërgjegjshëm për ndikimin që ka Kodi në marrjen e vendimeve etike lidhur me klientët dhe po kështu të kuptojnë sesi ky Kod ndikon në vlerat personale, në besimet dhe praktikën fetare - kulturore. Ata duhet t'i njohin konfliktet e mundshme mes vlerave personale dhe atyre profesionale dhe të dinë t'i përballojnë me përgjegjësi. Për udhëheqje të mëtejshme, punonjësit socialë duhet të shfletojnë literaturë mbi etikën profesionale dhe vendim-marrjen etike si dhe të kërkojnë konsultim të veçantë kur hasin dilema etike. Kjo mund të përfshijë konsultimin me komitete etike të shoqatave, organizatave të ndryshme të Punës Sociale, me trupa rregullues, kolegë me përvojë, supervizorë, apo këshillues ligjorë.

Probleme ngrihen kur detyrime etike të punonjësve socialë bien ndesh me politika të agjencisë, rregulla apo ligje. Kur shfaqen konflikte të këtij lloji, punonjësit socialë duhet të bëjnë përpjekje për t'i zgjidhur ato në mënyrë të tillë që t'u përmbahen vlerave, parimeve dhe standardeve të shprehura në këtë Kod. Në rastin kur nuk është e mundur një zgjidhje e arsyeshme e konfliktit, punonjësit socialë duhet të kërkojnë konsultime të veçanta përpara se të marrin vendime.

Kodi mund të përdoret nga individë, agjenci, organizata dhe organizma të tjerë si borde licensuese dhe rregulluese, gjykata, borde drejtuese të agjencive, institucione shtetërore, dhe grupe të tjera profesionistësh, të cilët zgjedhin ta përshtasin atë apo ta përdorin si pikë referimi. Dhunimi i standardeve të këtij Kodi nuk implikon automatikisht përgjegjësi ligjore ose shkelje të ligjit. Kjo mund të ndodhë vetëm në kontekstin e procedimit gjyqësor ligjor juridik. Shkeljet e Kodit mund të jenë subjekt i një procesi gjykimi nga ana e një grupi profesionistësh. Përgjithësisht, procese të tilla janë të ndara nga procedurat ligjore apo administrative, me qëllim që t'i lihet hapësirë profesionit të këshillojë dhe të disiplinojë anëtarët e vet.

Kodi Etik nuk mund të garantojë sjellje etike. Për më tepër, kodi nuk mund të zgjidhë të gjitha çështjet dhe dilemat etike, apo të mbulojë tërësinë dhe kompleksitetin që paraqet bërja e zgjedhjeve të arsyeshme në një komunitet të moralshëm. Kodi etik përcakton vlera bazë, parime dhe standarde etike tek të cilat mbështeten profesionistët dhe nëpërmjet të cilave veprimet e tyre mund të gjykohen. Sjellja etike e punonjësve socialë duhet të vijë si rezultat i përkushtimit personal për t'u angazhuar në praktikë etike. Kodi etik reflekton përkushtimin e të gjithë punonjësve socialë për të ruajtur vlerat e profesionit dhe për të vepruar në mënyrë etike.

Parimet Etike

Parimet e mëposhtme etike bazohen në vlerat themelore të Punës Sociale të shërbimit, drejtësisë sociale, dinjitetit dhe vlerës së personit, rëndësisë së marrëdhënieve njerëzore, integritetit dhe kompetencës. Këto parime përcaktojnë ideale të cilave u duhen përmbajtur të gjithë punonjësit socialë.

Vlera: Ofrim shërbimi

Parimi Etik: *Qëllimi kryesor i punonjësve socialë është të ndihmojnë njerëzit në nevojë si dhe të trajtojnë problemet sociale.*

Punonjësit socialë u japin shërbim të tjerëve përtej interesave personale. Ata mbështeten tek njohuritë, vlerat dhe shprehitë e tyre për të ndihmuar njerëzit në nevojë dhe për të zbutur problemet sociale. Punonjësit socialë inkurajohen të ofrojnë në mënyrë vullnetare një pjesë të shprehive të tyre profesionale pa pritur shpërblime të mëdha financiare.

Vlera: Promovim i Drejtësisë Sociale

Parimi Etik: *Punonjësit socialë sfidojnë padrejtësinë sociale.*

Punonjësit socialë synojnë ndryshimin social, kjo veçanërisht për hir dhe në emër të individëve apo grupeve vulnerable dhe të shtypur. Përpjekjet e punonjësve socialë për ndryshim social përqendrohen kryesisht në çështjet e varfërisë, papunësisë, diskriminimit, dhe formave të tjera të padrejtësisë sociale. Këto aktivitete tentojnë të nxisin ndjeshmërinë dhe njohuritë mbi përjashtimin social dhe diversitetin. Punonjësit socialë synojnë të lehtësojnë përdorimin e informacionit, shërbimeve dhe burimeve të nevojitura; të sigurojnë mundësi të barabarta; dhe pjesëmarrje të plotë në vendim-marrje për të gjithë njerëzit.

Vlera: respektim i Dinjitetit dhe Vlerave njerëzore

Parimi Etik: *Punonjësit socialë respektojnë dinjitetin dhe vlerën e lindur të personit.*

Punonjësit socialë e trajtojnë çdo person me respekt dhe përkujdes, duke qenë të ndërgjegjshëm për diferencat individuale, etnike dhe kulturore. Ata synojnë të rrisin kompetencën e klientëve për të ndryshuar dhe për të plotësuar vetë nevojat e tyre. Punonjësit socialë janë të vetëdijshëm për përgjegjësinë e tyre të dyfishtë karshi klientëve dhe shoqërisë në tërësi. Ata synojnë të zgjidhin konflikte midis interesave të klientëve dhe atyre të shoqërisë në mënyrë të përgjegjshme sociale, bazuar në vlerat, parimet dhe standardet etike të profesionit.

Vlera: Rëndësia e Marrëdhënieve Njerëzore

Parimi Etik: *Punonjësit socialë e pranojnë rëndësinë qendrore të marrëdhënieve njerëzore.*

Punonjësit socialë e kuptojnë që marrëdhëniet mes njerëzve janë një mjet shumë i rëndësishëm ndryshimi. Ata i angazhojnë njerëzit si partnerë gjatë procesit të ndihmës. Punonjësit socialë synojnë të forcojnë marrëdhëniet mes njerëzve me përpjekjen e

qëllimshme për të nxitur, ruajtur dhe pasuruar mirëqenien e individëve, familjeve, grupeve sociale, organizatave dhe komuniteteve.

Vlera: Integriteti

Parimi Etik: Punonjësit socialë sillen në mënyrë të besueshme.

Punonjësit socialë janë të vetëdijshëm për misionin e profesionit, vlerat, parimet e standardet etike dhe veprojnë duke u bazuar tek to. Punonjësit socialë sillen ndershmërisht dhe promovojnë praktiket etike në institucionin ku janë punësuar.

Vlera: Kompetenca

Parimi Etik: Punonjësit socialë ofrojnë shërbime brenda fushës së tyre dhe zhvillojnë e pasurojnë ekspertizën profesionale.

Punonjësit socialë mundohen vazhdimisht të rrisin njohuritë dhe shprehitë profesionale dhe më pas t'i aplikojnë ato në praktikë. Ata duhet të kontribuojnë në njohuritë bazë të profesionit.

KREU 1-Standardet Etike

Standardet e mëposhtme etike janë të rëndësishme për aktivitetin profesional të të gjithë punonjësve socialë. Ato janë: (1) përgjegjësitë etike të punonjësit social ndaj klientit; (2) përgjegjësitë etike të punonjësit social ndaj kolegëve; (3) përgjegjësitë etike të punonjësit social në vendin e punës; (4) përgjegjësitë etike të punonjësit social si profesionist; (5) përgjegjësitë etike të punonjësit social ndaj profesionit të Punës Sociale; (6) përgjegjësitë etike të punonjësit social ndaj shoqërisë në tërësi.

Disa nga standardet që vijojnë janë të detyrueshme për sjelljen profesionale, ndërsa të tjerat janë fakultative. Shkalla e detyrueshmërisë është çështje e gjykimit profesional që do të ushtrohet nga personat përgjegjës për vlerësimin e shkeljeve të standardeve etike, të caktuar nga Urdhëri.

2. Përgjegjësitë Etike të Punonjësve Socialë ndaj Klientëve

2.01 Përkushtimi ndaj klientëve

Përgjegjësia kryesore e punonjësve socialë është të promovojnë mirëqenien e klientëve. Në përgjithësi, interesat e klientit konsiderohen si parësore. Megjithatë, në raste të veçanta, përgjegjësia e punonjësve socialë ndaj shoqërisë në tërësi apo ndaj detyrimeve specifike ligjore mund ta tejkalojë besnikërinë ndaj klientëve, dhe për këtë klientët duhen paralajmëruar. (Shembuj janë rastet kur një punonjësi social raporton në gjykatë si ekspert apo dëshmitar nëse klienti ka abuzuar me fëmijën, ose ka kërcënuar se do t'i bëjë dëm vetes apo të tjerëve.)

2.02 Vetëvendosja

Punonjësit socialë respektojnë dhe nxisin të drejtën e klientit për vetëvendosje dhe i ndihmojnë klientët në përpjekjet për të identifikuar dhe qartësuar qëllimet e tyre. Punonjësit socialë mund ta kufizojnë të drejtën e klientëve për vetëvendosje kur, sipas gjykimit të tyre profesional, veprimet konkrete apo potenciale të klientëve përbëjnë një rrezik serioz, kërcënues për veten apo për të tjerët.

2.03 Miratimi i Informuar

- (a) Punonjësit socialë duhet t'u ofrojnë shërbime klientëve në kontekstin e një marrëdhënieje profesionale, ku ekziston konsensusi. Punonjësit socialë duhet të përdorin gjuhë të kuptueshme dhe të qartë për t'i informuar klientët mbi qëllimin e shërbimeve, rreziqet dhe kufizimet e lidhura me to, kostot e mundshme, alternativat e arsyeshme, të drejtën e klientit për të refuzuar apo tërhequr miratimin e dhënë më parë, dhe kuadrin kohor që mbulon marrëveshja. Punonjësit socialë duhet t'u sigurojnë klientëve mundësinë e shtrimit të pyetjeve.
- (b) Në rastet kur klientët nuk janë të shkolluar ose kanë vështirësi në të kuptuarin e gjuhës së përdorur, punonjësit socialë duhet të ndërmarrin hapa për të siguruar qartësimin e klientit. Kjo mund të përfshijë shpjegimin verbal të detajuar, apo kur është e mundur, marrjen e një përkthyesi të kualifikuar.
- (c) Në rastet kur klientëve u mungon aftësia për të dhënë miratimin, punonjësit socialë duhet të mbrojnë interesat e klientëve duke kërkuar leje nga një palë e tretë. Në këto raste punonjësi social duhet të sigurohet që pala e tretë të veprojë në përputhje me dëshirat dhe interesat e klientit. Punonjësit socialë duhet të ndërmarrin hapa për të rritur aftësinë e klientëve për të bërë marrëveshje.
- (d) Në rastet kur klientët marrin shërbime jovullnetarisht, punonjësit socialë duhet të japin informacion për natyrën dhe shtrirjen e shërbimeve si dhe për të drejtën e klientit për ta refuzuar shërbimin.
- (e) Punonjësit socialë që ofrojnë shërbime nëpërmjet medieve elektronike (si p.sh kompjuterit, telefonit, radios dhe televizionit) duhet ta informojnë bashkëbiseduesin për kufizimet dhe rreziqet që lidhen me të tilla shërbime.
- (f) Punonjësit socialë duhet të marrin miratimin e klientit përpara regjistrimit në magnetofon ose video, apo lejen që një palë e tretë të mund të vëzhgojë shërbimin e dhënë.

1.04 Kompetencat/Aftësitë dhe shprehjet

- (a) Punonjësit socialë duhet të ofrojnë shërbime dhe të marrin kompetenca vetëm brenda kufijve që i lejon edukimi, trajnimi, licenca, certifikimi, konsultimi i marrë, eksperiencia e supervizuar, apo eksperiencia të tjera të rëndësishme profesionale.
- (b) Punonjësit socialë duhet të ofrojnë shërbime apo të përdorin teknika të reja të ndërhyrjes vetëm pas një studimi të gjatë, trajnimi, konsultimi dhe supervizimi nga njerëz kompetentë në këto teknika apo ndërhyrje.
- (c) Kur standardet tashmë të njohura nuk përshtaten në një fushë të re të praktikës së Punës Sociale, punonjësit socialë duhet të ushtrojnë gjykim të kujdesshëm dhe të ndërmarrin hapa të përgjegjshëm (duke përfshirë edukimin e duhur, kërkim, trajnim,

konsultim, dhe supervizim) për të siguruar kompetencën në punë dhe për të mbrojtur klientët nga dëmtimi.

1.05 Kompetencat/Aftësitë dhe shprehitë Kulturore dhe Diversiteti Social

- (a) Punonjësit socialë duhet të kuptojnë kulturën dhe funksionin e saj si në sjelljen njerëzore ashtu edhe në shoqëri, duke njohur pikat e forta ekzistuese në të gjitha kulturat.
- (b) Punonjësit socialë duhet të kenë njohuri bazë për kulturën e klientëve si dhe të jenë të aftë të tregojnë kompetencë në sigurimin e shërbimeve që janë të ndjeshme ndaj kulturës së klientit dhe ndaj diferencave mes njerëzve dhe grupeve kulturore.
- (c) Punonjësit socialë duhet të marrin edukim dhe të kërkojnë të kuptojnë natyrën e diversitetit social dhe shtypjes me bazë gjininë, moshën, racën, etninë, origjinës kombëtare, ngjyrën, orientimin seksual, statusit martesor, bindjes politike, besimit fetar, ose aftësisë së kufizuar mendore apo fizike.

1.06 Konflikti i Interesave

- (a) Punonjësit socialë duhet të jenë të kujdesshëm të shmangin konfliktet e interesave, të cilat ndërhyjnë në ushtrimin e zgjedhjeve profesionale dhe në gjykimin e paanshëm. Punonjësit socialë duhet t'i informojnë klientët kur ngrihet një konflikt real apo potencial interesash. Ata duhet të ndërmarrin hapa për ta zgjidhur çështjen në atë mënyrë, e cila vë në plan të parë interesat e klientit dhe që i mbron këto interesa në masën më të madhe të mundshme. Në disa raste, mbrojtja e interesave të klientit mund të kërkojë përfundimin e marrëdhënies profesionale me vetë pranimin e klientit.
- (b) Punonjësit socialë nuk duhet të përfitojnë nga marrëdhënia profesionale dhe të shfrytëzojnë të tjerët për interesat e tyre personale, fetare, politike, apo ekonomike.
- (c) Punonjësit socialë nuk duhet të përfshihen në marrëdhënie të dyfishta apo të shumëfishta me klientë apo ish-klientë, në të cilat ka rrezik shfrytëzimi ose dëmtimi potencial të klientit. Në rastet kur, marrëdhëniet e dyfishta apo të shumëfishta janë të pashmangshme, punonjësit socialë duhet të ndërmarrin hapa për të mbrojtur klientët dhe duhet të jenë të përgjegjshëm për përcaktimin e kufijve të duhura, të qarta dhe që i përshtaten kulturës. (Marrëdhëniet e dyfishta apo të shumëfishta shfaqen kur punonjësit socialë lidhen me klientët në më shumë se një lloj marrëdhënieje, qoftë profesionale, sociale apo ekonomike. Marrëdhëniet e dyfishta apo të shumëfishta mund të shfaqen njëkohësisht apo njëra pas tjetrës.)
- (d) Kur punonjësit socialë i ofrojnë shërbime dy ose më shumë personave të cilët kanë marrëdhënie me njëri-tjetrin (p.sh. çifte, anëtarë të familjes), ata duhet t'i qartësojnë të gjitha palët se cilët individë do të konsiderohen klientë, si dhe duhet të japin informacion mbi natyrën e detyrimeve profesionale të punonjësit social ndaj individëve të ndryshëm të cilët po marrin shërbime. Punonjësit socialë që parashikojnë një konflikt interesash mes individëve që marrin shërbimet, apo që parashikojnë pjesëmarrjen në një konflikt potencial rolesh (p.sh. kur një punonjësi social i kërkohet të dëshmojë gjatë një seance mbi cilësinë e kujdestarisë ndaj fëmijës, procedurë kjo që përfshin klientët) duhet të qartësojnë rolin e tyre me palët e

përfshira dhe të ndërmarrin veprimet e duhura për të minimizuar çdo konflikt të mundshëm interesash.

1.11 Privatësia dhe Konfidencialiteti

- (a) Punonjësit socialë duhet të respektojnë të drejtën e klientëve për privatësi. Ata nuk duhet të kërkojnë informacion privat deri atëherë kur kjo është esenciale për ofrimin e shërbimeve, apo për ecurinë e vlerësimit dhe kërkimit në Punë Sociale. Në momentin kur jepet informacioni privat, fillojnë të zbatohen standardet e konfidencialitetit.
- (b) Punonjësit socialë mund ta bëjnë publik informacionin konfidencial në rastet kur kjo është e domosdoshme, me aprovimin e klientit ose të një personi të autorizuar me ligj për ta dhënë atë në emër të klientit.
- (c) Punonjësit socialë duhet ta ruajnë konfidencialitetin mbi të gjithë informacionin e marrë gjatë shërbimit profesional, me përjashtim të rasteve kur ka arsye profesionale detyruese për të mos e bërë këtë. Opinioni i përgjithshëm se punonjësit socialë duhet ta ruajnë informacionin konfidencial, nuk zë vend në rastet kur dhënia e informacionit është e nevojshme për parandalimin e një dëmtimi serioz, të parashikueshëm dhe të mundshëm të vetë klientit apo të personave të tjerë të identifikueshëm, ose kur rregullat dhe ligjet e kërkojnë një gjë të tillë qoftë edhe pa miratimin e klientit. Në të gjitha rastet, punonjësit socialë duhet të japin sasinë më të vogël të mundshme të informacionit, që do të ishte i mjaftueshëm për përmbushjen e qëllimit; jepet vetëm informacioni që është direkt i lidhur me qëllimin për të cilin ky informacion po bëhet publik.
- (d) Punonjësit socialë duhet t'i informojnë klientët për rastet e bërjes publik të informacionit konfidencial dhe për pasojat e mundshme, përpara se të bëhen të njohura të dhënat private. Kjo aplikohet atëherë kur punonjësit socialë e japin informacionin konfidencial për të përmbushur një kërkesë ligjore apo vetë dëshirën e klientit.
- (e) Punonjësit socialë duhet të diskutojnë me klientët apo me palët e interesuara natyrën e konfidencialitetit dhe kufizimet në të drejtat e klientëve për konfidencialitet. Së bashku me klientët, punonjësit socialë duhet të shqyrtojnë situatat ku mund të kërkohej të bëhet publik informacioni konfidencial. Ky diskutim duhet bërë që në hapat e parë të marrëdhënies punonjës social – klient dhe vazhdon gjatë gjithë ecurisë së marrëdhënies.
- (f) Kur punonjësit socialë i ofrojnë shërbime këshillimi familjeve, çifteve, ose grupeve duhet të bien dakord me të gjitha palët e përfshira përse i përket të drejtës individuale të secilit për konfidencialitet si dhe detyrimin për ta ruajtur konfidencialitetin e informacionit të marrë nga të tjerët. Punonjësit socialë duhet t'i informojnë pjesëmarrësit në këshillimin në familje, çifte apo grupe se ata nuk mund të garantojnë respektimin e një marrëveshjeje të tillë nga të gjithë anëtarët.
- (g) Punonjësit socialë duhet t'i informojnë klientët e përfshirë në këshillim familjar, çifti, martesor apo grupi mbi politikën e ndjekur nga punonjësi social, punëdhënësi dhe agjencia në rastet e bërjes së njohur të informacionit konfidencial palëve të përfshira në këshillim.
- (h) Punonjësit socialë nuk duhet t'ia japin informacionin konfidencial një pale të tretë derisa vetë klienti ta autorizojë një veprim të tillë.

- (i) Punonjësit socialë nuk duhet ta diskutojnë informacionin konfidencial në ambiente ku nuk mund të sigurohet privatësia. Ky informacion nuk duhet dhënë në vende publike të tilla si restorante, ashensorë etj.
- (j) Punonjësit socialë duhet ta ruajnë konfidencialitetin e klientëve gjatë procedurave ligjore, në masën e lejuar nga ligji. Ndodh që një gjykatë apo një tjetër trup ligjërish i autorizuar t'i urdhërojë punonjësit social të japë informacion konfidencial pa miratimin e klientit edhe kur një gjë e tillë mund t'i shkaktojë dëm këtij klienti. Në këtë rast punonjësi social duhet t'i kërkojë gjykatës ta tërheqë urdhrin apo ta kufizojë atë sa më shumë të jetë e mundur, ose t'i ruajë të dhënat nën mbikëqyrje duke ndaluar ekspozimin publik.
- (k) Punonjësit socialë duhet ta mbrojnë konfidencialitetin e klientëve kur u përgjigjen pyetjeve të bëra nga përfaqësues të medieeve.
- (l) Punonjësit socialë duhet ta mbrojnë konfidencialitetin e të dhënave të shkruara të klientëve. Ata duhet të ndërmarrin hapa për të ruajtur në vende të sigurta të dhënat e klientëve, të cilat nuk u jepen personave të paautorizuar.
- (m) Punonjësit socialë duhet të jenë të kujdesshëm që ta sigurojnë dhe ta ruajnë konfidencialitetin e informacionit, i cili u transmetohet palëve të tjera nëpërmjet kompjuterave, postës elektronike, faksit, telefonit etj. Bërja publike e informacionit identifikues duhet shmangur kurdoqoftë e mundur.
- (n) Punonjësit socialë duhet t'i mbajnë të dhënat në atë formë që të ruhet konfidencialiteti i klientëve, formë kjo që përshtatet me rregullat e dokumentimit dhe licencimit në Punë Sociale.
- (o) Punonjësit socialë duhet të marrin masa paraprake për të mbrojtur konfidencialitetin e klientit në rastet kur punonjësi social mbyll praktikën e vet profesionale, vdes apo është i paaftë të ofrojë ndihmë të mëtejshme.
- (p) Punonjësit socialë nuk duhet ta bëjnë të njohur informacionin identifikues kur flasin për klientët e tyre për qëllime mësimi apo trajnimi, derisa klienti ta ketë dhënë vetë lejen për një veprim të tillë.
- (q) Punonjësit socialë nuk duhet ta bëjnë të njohur informacionin identifikues kur diskutojnë për klientët me supervisorët, derisa klienti ta ketë dhënë miratimin apo derisa të ketë nevojë të domosdoshme për një gjë të tillë.
- (r) Punonjësit socialë duhet ta ruajnë konfidencialitetin e klientëve të vdekur duke u bazuar në standardet e mëparshme.

1.08 E drejta mbi Dosjet

- (a) Punonjësit socialë duhet t'u sigurojnë klientëve të drejtën për t'u njohur me dosjet e tyre. Ata profesionistë që shqetësohen për faktin se leximi i dosjet nga klientët mund të shkaktojë keqkuptime serioze ose dëme, duhet të ofrojnë ndihmë në interpretimin e shënimeve dhe konsultim me klientin përsa i përket këtyre të dhënave. Punonjësit socialë duhet ta kufizojnë të drejtën e klientëve ndaj dosjeve, apo pjesëve të veçanta të tyre, vetëm në rrethana të jashtëzakonshme kur ka evidenca të qarta që një gjë e tillë do t'i shkaktonte dëm serioz klientit. Si kërkesat e klientit, ashtu edhe motivet për mbajtjen fshehtë të një pjese të dosjes së klientit, apo të tërë dosjes duhet të jenë të dokumentuara në skedën e klientit.

- (b) Kur klientëve u jepet mundësia për të parë kartelat e tyre, punonjësit socialë duhet të ndërmarrin hapa për të ruajtur konfidencialitetin e individëve të tjerë të identifikuar e të përmendur në këto kartela.

1.09 Marrëdhëniet Seksuale

- (a) Punonjësit socialë në asnjë mënyrë nuk duhet të përfshihen në aktivitete apo kontakte seksuale me klientë aktualë, qoftë ky kontakt konsensual apo i detyruar me forcë.
- (b) Punonjësit socialë nuk duhet të përfshihen në aktivitete seksuale me të afërm të klientëve apo individë të tjerë me të cilët klientët kanë marrëdhënie të ngushta personale, kur ka rrezik shfrytëzimi apo dëmtimi të mundshëm të klientit. Aktiviteti apo kontakti seksual me persona të afërt për klientin ka mundësi të mëdha për të qenë i dëmshëm dhe mund ta vështirësojë ruajtjen e kufijve të duhur profesionalë mes punonjësit social dhe klientit. Punonjësit socialë – jo klientët e tyre, as të afërmit e klientëve, dhe as individë të tjerë me të cilët klienti ka marrëdhënie personale – kanë përgjegjësinë e plotë të përcaktimit të kufijve të qartë, të duhur dhe të ndjeshëm ndaj kulturës përkatëse.
- (c) Punonjësit socialë nuk duhet të përfshihen në aktivitete apo kontakte seksuale me klientë të mëparshëm, për shkak të dëmtimit shumë të mundshëm të klientit. Në rast se punonjësit socialë sillen në kundërshtim me këtë rregull ose pretendojnë se është i nevojshëm një përjashtim për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme, janë ata – dhe jo klientët e tyre – që marrin përgjegjësinë e plotë për të vërtetuar që klienti i mëparshëm nuk është shfrytëzuar, detyruar ose manipuluar me qëllim apo pa qëllim.
- (d) Punonjësit socialë nuk duhet t'u ofrojnë shërbime klinike individëve me të cilët kanë patur më parë marrëdhënie seksuale. Dhënia e shërbimeve klinike ndaj ish-partnerëve seksualë përbën rrezik dëmtimi për individin, si dhe vështirëson ruajtjen e kufijve të duhur profesionalë mes punonjësit social dhe klientit.

1.10 Kontakti Fizik

Punonjësit socialë nuk duhet të kenë kontakte fizike me klientët, atëherë kur ekziston mundësia e dëmtimit psikologjik të klientit si pasojë e këtij kontakti. Punonjësit socialë që përfshihen në kontakte fizike me klientët janë përgjegjës për përcaktimin e kufijve të qartë e të duhur, të cilët edhe udhëheqin kontaktin fizik.

1.11 Ngacmimi Seksual

Punonjësit socialë nuk duhet të ngacmojnë seksualisht klientët. Ngacmimi seksual përfshin përfitimet dhe pretendimet seksuale, kërkesat për favore seksuale, apo sjellje verbale ose fizike të natyrës seksuale.

1.12 Të Folurit Fyes

Punonjësit socialë nuk duhet të përdorin gjuhë denigruese gjatë komunikimit verbal apo të shkruar me klientët. Punonjësit socialë duhet të përdorin gjuhë të përzgjedhur dhe të respektueshme kur flasin me dhe për klientët e tyre.

1.17 Pagesa për Shërbimet

- (a) Gjatë përcaktimit të pagesës, punonjësit socialë duhet të sigurojnë pagesa të ndershme, të arsyeshme, dhe të krahasueshme me shërbimet e dhëna. Duhet marrë në konsideratë edhe mundësia e klientit për të paguar.
- (b) Punonjësit socialë duhet të shmangin pranimin e të mirave materiale apo të shërbimeve nga klientët si formë shpërblimi për shërbimet profesionale. Shkëmbimi i shërbimeve krijon mundësi për konflikte interesash, shfrytëzim, dhe kufij jo të përshtatshëm në marrëdhëniet e punonjësit social me klientët. Punonjësit socialë mund të marrin pjesë në të tillë shkëmbim vetëm në rrethana shumë të kufizuara, kur mund të demonstrohet që kjo është një praktikë e pranuar nga profesionistët në komunitetin lokal. Në këto raste, ky shkëmbim është esencial për sigurimin e shërbimeve, i pranuar pa detyrim, i aplikuar me iniciativën e vetë klientëve si dhe me miratimin e tyre joformal. Punonjësit socialë të cilët pranojnë të mira ose shërbime nga klientët si shpërblim për shërbimet profesionale marrin përgjegjësinë e plotë për të demonstruar që ky shkëmbim nuk do të jetë i dëmshëm për klientin ose për marrëdhënien profesionale.
- (c) Punonjësit socialë nuk duhet të përcaktojnë një pagesë private apo kompensime të tjera për sigurimin e shërbimeve ndaj klientëve, të cilët i përfitojnë shërbimet në fjalë nëpërmjet agjencisë.

1.14 Klientët të Cilëve u Mungon Aftësia për Vendim-marrje

Kur punonjësit socialë veprojnë në emër të klientëve, të cilëve u mungon aftësia për të marrë vendime, duhet të ndërmarrin hapa të kujdesshëm për të ruajtur interesat dhe të drejtat e këtyre klientëve, në përputhje me ligjet në fuqi.

1.15 Ndërprerja e Shërbimeve

Punonjësit socialë duhet të bëjnë përpjekje për të siguruar vazhdimësinë e shërbimeve edhe në rastet kur këto shërbime ndërpriten nga faktorë si ndryshimi i vendit, sëmundja, paaftësia, ose vdekja.

1.16 Përfundimi i Shërbimeve

- (a) Punonjësit socialë duhet t'i japin fund shërbimeve ndaj klientëve dhe marrëdhënieve profesionale me ta, kur shërbime dhe marrëdhënie të tilla nuk kërkohen më gjatë dhe nuk i shërbejnë më nevojave dhe interesave të klientëve.
- (b) Punonjësit socialë duhet të shmangin braktisjen e klientëve të cilët kanë akoma nevojë për shërbime. Ata duhet t'i ndërpresin shërbimet menjëherë vetëm në rrethana të jashtëzakonshme, duke marrë në konsideratë të gjithë faktorët rrethanorë si dhe duke u kujdesur për minimizimin e efekteve të mundshme negative. Kur është e nevojshme, punonjësit socialë duhet të ndihmojnë në gjetjen e mundësive të tjera për vazhdimin e shërbimeve.
- (c) Punonjësit socialë në agjencitë ku ofrohen shërbime të paguara, mund t'i ndërpresin shërbimet ndaj klientëve të cilët nuk derdhen pagesën e plotë, nëse rregullat financiare

të kontratës i janë bërë të qarta këtij klienti më parë, nëse klienti nuk përbën rrezik për veten apo për të tjerët, dhe nëse pasojat klinike apo pasoja të formave të tjera të mospagimit aktual janë prekur dhe diskutuar më parë me klientin.

- (d) Punonjësit socialë nuk duhet t'i japin fund shërbimeve me qëllim vazhdimin e një marrëdhënieje sociale, financiare apo seksuale me klientin.
- (e) Punonjësit socialë, të cilët i japin fund apo i ndërpresin shërbimet përpara afatit të duhur, duhet t'i informojnë klientët dhe të kërkojnë transferimin, referimin, ose vazhdimin e shërbimeve në varësi të nevojave dhe preferencave të vetë klientëve.
- (f) Punonjësit socialë që do të largohen nga një vend pune duhet t'i informojnë klientët për mundësi të tjera të vazhimit të shërbimeve si dhe për përfitimet dhe rreziqet e tyre.

KREU 2-Përgjegjësitë Etike të Punonjësve Socialë ndaj Kolegëve.

2.01. Respekti

- (a) Punonjësit socialë duhet t'i trajtojnë kolegët me respekt dhe të tregojnë se janë përfaqësues të një ekipi cilësor dhe të kualifikuar.
- (b) Punonjësit socialë duhet të shmangin në komunikimin me klientët dhe profesionistët e tjerë kritikën ngacmuese me qëllime negative. Këto kritika përfshijnë komente poshtëruese që vënë në pikëpyetje kompetencën dhe cilësitë e kolegut, gjininë dhe racën së cilës ai i përket, besimin fetar, përkatësinë kombëtare, orientimin seksual, statusin martesor dhe deri aftësitë fizike e mendore.
- (c) Punonjësit socialë duhet të bashkëpunojnë me kolegë të Punës Sociale dhe me profesionistë të fushave të tjera, sidomos në rastet kur ky bashkëpunim i shërben mirëqenies së klientit.

2.02. Konfidencialiteti

Punonjësit socialë duhet të respektojnë dhe të ruajnë privatësinë e informacionit konfidencial që shkëmbehet midis kolegëve brenda kuadrit të tyre profesional. Punonjësit socialë duhet të sigurohen më parë se kolegët me të cilët ata e shkëmbejnë këtë informacion e kuptojnë dhe e njohin detyrimin etik për ruajtjen e konfidencialitetit dhe rastet kur ky konfidencialitet mund të thyhet.

2.03 Marrëdhëniet ndërdisiplinore

- (a) Punonjësit socialë, anëtarë të ekipit multidisiplinar, të udhëhequr nga vlerat, parimet dhe etika e profesionit duhet të marrin pjesë aktive dhe të kontribuojnë në vendimet që merren brenda ekipit për klientët dhe ndikojnë në mirëqenien e tyre. Detyrimet profesionale dhe etike të anëtarëve të ekipit në veçanti dhe të vetë ekipit në përgjithësi duhet të jenë të përcaktuara hapur dhe qartë.
- (b) Punonjësit socialë që vënë re se vendimet që merren në ekip shkaktojnë probleme etike, duhet të përpiqen t'i zgjidhin këto probleme sipas rregullave të përcaktuara për

këto raste. Në qoftë se edhe pas kësaj këto probleme nuk gjejnë zgjidhjen e duhur punonjësit socialë duhet të gjejnë rrugë dhe mjete të tjera për të trajtuar problemin etik që prek mirëqenien e klientit.

2.04 Mosmarrëveshjet midis kolegëve

- (a) Punonjësit socialë nuk duhet të përfitojnë nga konflikti midis kolegut dhe punëdhënësit, me qëllim që të fitojnë një pozitë më të lartë në hierarki apo të përmbushin interesa të caktuara personale.
- (b) Punonjësit socialë nuk duhet t'i shfrytëzojnë apo t'i përfshijnë klientët në konfliktet e tyre me kolegët.

2.05 Konsultimi

- (a) Punonjësit socialë duhet të konsultohen me kolegët sa herë që e kërkojnë interesat e klientëve.
- (b) Punonjësit socialë duhet të jenë të mirëinformuar mbi kompetencat dhe profesionalizmin e kolegëve të tyre. Punonjësit socialë duhet të kërkojnë të konsultohen vetëm me ata kolegë që kanë treguar se janë kompetentë apo ekspertë të çështjes që lidhet me subjektin e konsultimit.
- (c) Gjatë konsultimit me kolegët punonjësit socialë duhet të shkëmbejnë informacionin më të pakët të mundshëm, i nevojshëm ky për arritjen e qëllimit të konsultimit.

2.06 Referimi për shërbimet

- (a) Punonjësit socialë duhet ta referojnë klientin tek profesionistë të tjerë, në rastet kur ata mendojnë se nuk janë efektivë dhe nuk po bëjnë progres në punën me klientin, apo në rastet kur klienti ka nevojë për shërbime të tjera profesionale me qëllim që t'i shërbehet atij në mënyrë sa më të plotë.
- (b) Punonjësit socialë që i referojnë klientët tek profesionistë të tjerë duhet të marrin masat e duhura për të lehtësuar kalimin e përgjegjësiave tek kolegu i tyre. Punonjësit socialë që referojnë klientët tek profesionistët e tjerë duhet të marrin pëlqimin e klientit për informacionin që ata i japin në lidhje me klientin ofruesit të ri të shërbimeve.
- (c) Punonjësit socialë ndalohen të japin dhe të marrin pagesa për referimin që bëjnë në qoftë se klientit nuk i sigurohet asnjë shërbim profesional nga punonjësi social ku u referua.

2.07 Marrëdhëniet seksuale

- (a) Punonjësit socialë në funksionin e supervizorit apo edukatorit nuk duhet të përfshihen në marrëdhënie seksuale me studentët, personat që trajnojnë apo dhe me kolegët ndaj të cilëve ushtrojnë një autoritet profesional.

- (b) Punonjësit socialë duhet të shmangin marrëdhëniet seksuale me kolegët në rastet kur ekziston një rrezik potencial për konflikte interesash midis dy palëve. Kur punonjësit socialë përfshihen ose parashikojnë të përfshihen në marrëdhënie seksuale me një koleg kanë për detyrë të transferojnë, kur është e nevojshme, përgjegjësitë e tyre profesionale për të evituar konfliktin e interesave.

2.08 Ngacmimet seksuale

Punonjësit socialë nuk duhet të ngacmojnë seksualisht studentët, personat që supervizojnë dhe trajnojnë, si dhe kolegët e tyre. Ngacmimi seksual përfshin çdo kërkesë për marrëdhënie dhe përfitim seksual, si dhe çdo lloj sjellje verbale dhe fizike me natyrë seksuale.

2.09 Dëmtimi i kolegëve

- (a) Punonjësit socialë që janë në dijeni për problemet personale të kolegut si shqetësime psikologjike, abuzim me substanca të ndryshme apo probleme të shëndetit mendor të cilat pengojnë efektivitetin e tij në punë, duhet të konsultohen me kolegun dhe kur të jetë e mundur ta ndihmojnë që të ndër marrë veprime për rehabilitimin e tij.
- (b) Kur punonjësit socialë mendojnë se problemet personale të një kolegu pengojnë efikasitetin e tij në punën me klientët dhe kur ata mendojnë se në të njëjtën kohë kolegu nuk po ndërmerr asnjë veprim për të trajtuar problemet e tij, punonjësit socialë duhet të veprojnë në bazë të rregullave të vendosura për këto raste nga punëdhënësi, agjencia ku ata punojnë, Urdhëri i Punonjësve Socialë, Bordi për Licensimin e Punonjësve Socialë si dhe nga organizata të tjera profesionale.

2.10 Paaftësia profesionale e kolegëve

- (a) Kur punonjësit socialë kanë informacion të saktë për paaftësinë e kolegut të tyre duhet të konsultohen me të dhe kur të jetë e mundur ta ndihmojnë atë të ndërmarrë veprime për të ndryshuar këtë situatë.
- (b) Punonjësit socialë të cilët besojnë se kolegu i tyre nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për të ndryshuar situatën kundrejt paaftësisë së tij, duhet të veprojnë në bazë të rregullave të vendosura për këto raste nga punëdhënësi, agjencia ku punojnë, Urdhëri i Punonjësve Socialë, Bordi për Licensimin e Punonjësve Socialë si dhe nga organizata të tjera profesionale.

2.11 Sjellja joetike e kolegëve.

- (a) Punonjësit socialë duhet të marrin masat e duhura për të dekurajuar, parandaluar, demaskuar dhe ndrequr sjelljet joetike të kolegëve të tyre.
- (b) Punonjësit socialë duhet të jenë të mirëinformuar mbi politikën dhe procedurat e përcaktuara për të trajtuar shqetësimet për sjelljet joetike të kolegëve. Punonjësit socialë duhet të jenë të familjarizuar me procedurat kombëtare, shtetërore, dhe lokale

për trajtimin e çështjeve shqetësuese etike. Këtu përfshihen politikat dhe procedurat e vendosura nga punëdhënësi, agjencia ku punon punonjësi social, Urdhëri i Punonjësve Socialë, Bordi për Licensimin e Punonjësve Socialë si dhe nga organizata të tjera profesionale.

- (c) Punonjësit socialë që besojnë se kolegu i tyre është sjellë në mënyrë joetike duhet t'i diskutojnë shqetësimet e tyre me kolegun, atëherë kur e shohin të arsyeshme dhe mendojnë se ky diskutim mund të jetë produktiv.
- (d) Kur është e nevojshme, punonjësit socialë që besojnë se kolegu i tyre është sjellë në mënyrë joetike duhet të marrin masat për të vepruar në bazë të rregullave të vendosura për këtë rast, si të kontaktojnë me Bordin e Licensimit të Punonjësve Socialë, Komitetin e Urdhërit të Punonjësve Socialë apo me komitete të tjera që trajtojnë çështje të etikës profesionale.
- (e) Punonjësit socialë duhet të ndihmojnë dhe të mbrojnë ata kolegë që janë akuzuar pa të drejtë për shkelje të etikës profesionale.

KREU 3-Përgjegjësitë Etike të Punonjësve Socialë në Praktikë.

3.01 Supervizimi dhe Konsultimi

- (a) Punonjësit socialë që ofrojnë supervizim dhe konsultim, duhet të kenë njohuritë dhe shprehjet e nevojshme për supervizim, konsultim dhe duhet të veprojnë brenda fushës së njohurive dhe kompetencës së tyre profesionale.
- (b) Punonjësit socialë që bëjnë supervizim dhe këshillim janë përgjegjës për vendosjen e kufijve të qartë midis tyre dhe personave që supervizojnë.
- (c) Punonjësit socialë nuk duhet të përfshihen në marrëdhënie të dyzuara ose të shumëfishta me të supervizuarin, kur ekziston rreziku i shfrytëzimit ose dëmtimit potencial të supervizimit.
- (d) Punonjësit socialë që supervizojnë duhet të vlerësojnë me respekt, e në mënyrë të drejtë të supervizuarit.

3.02 Trajnimi dhe Edukimi

- (a) Punonjësit socialë që janë në rolin e edukatorit, instruktorit në terren për studentët, trajnerit, duhet të japin informacion brenda fushës së njohurive dhe kompetencës së tyre profesionale. Ky informacion duhet të jetë i kohëve të fundit dhe i vlefshëm për profesionin.
- (b) Punonjësit socialë në rolin e edukatorit ose të instruktorit në terren për studentët duhet të vlerësojnë me respekt e në mënyrë të drejtë punën e studentëve.
- (c) Punonjësit socialë në rolin e edukatorit, instruktorit në terren për studentët duhet të ndërmarrin hapa të përgjegjshëm për t'u siguruar se klientëve u bëhen të ditura në mënyrë të vazhdueshme rastet kur shërbimi ndaj tyre ofrohet nga studentët praktikantë.
- (d) Punonjësit socialë në rolin e edukatorit ose të instruktorit në terren për studentët, nuk duhet të përfshihen në marrëdhënie të dyzuara ose të shumëfishta me studentët, veçanërisht në rastet kur ekziston rreziku potencial për dëmtimin e studentëve.

Punonjësit socialë në rolin e edukatorit ose të instruktorit në terren për studentët janë përgjegjës për vendosjen e kufijve të qartë midis tyre dhe studentëve.

3.03 Vlerësimi i punës

Punonjësit socialë, të cilët bëjnë vlerësimin e punës së të tjerëve duhet ta përmbushin këtë detyrë me përgjegjësi të plotë e në mënyrë të drejtë, mbi bazën e kriterëve të qarta.

3.09 Regjistrimi i të dhënave për klientin.

- (a) Punonjësit socialë me përgjegjësi të plotë duhet të sigurohen që të dhënat e regjistruara për klientin të jenë të sakta dhe të pasqyrojnë shërbimin e ofruar.
- (b) Punonjësit socialë duhet të regjistrojnë të dhëna të mjaftueshme dhe në kohën e duhur, me qëllim që të lehtësojnë shpërndarjen e shërbimeve dhe të sigurojnë vazhdimësinë e tyre për klientët në të ardhmen.
- (c) Të dhënat e regjistruara nga punonjësit socialë duhet të ruajnë privatësinë e klientit dhe në këto regjistrime duhet të përfshihen vetëm të dhënat që janë të lidhura direkt me shpërndarjen e shërbimeve.
- (d) Punonjësit socialë duhet të depozitojnë të dhënat e regjistruara në përfundim të shërbimit, me qëllim që të mundësojnë përdorimin e përgjegjshëm të tyre në të ardhmen. Të dhënat e regjistruara duhet të ruhen për disa vjet, sipas kontratës së nënshkruar.

3.10 Kontrata e shërbimeve

Punonjësit socialë duhet të krijojnë dhe të ruajnë një praktikë kontrate për shërbimet, e cila do të pasqyrojë natyrën, gjerësinë e shërbimit dhe do të identifikojë kush e ofron këtë shërbim në praktikë.

3.11 Transferimi i Klientit

- (a) Kur klienti është duke marrë shërbim nga një agjenci tjetër shërbimesh apo nga një koleg tjetër brenda së njëjtës agjenci dhe kontakton punonjësin social për një shërbim të ri, ky i fundit duhet të vlerësojë me kujdes nevojat e klientit përpara se të pranojë t'i ofrojë atij shërbimin. Për të minimizuar konfliktin dhe konfuzionin e mundshëm punonjësit socialë duhet të diskutojnë me klientin e tyre potencial mbi natyrën e marrëdhënieve të klientit me ofruesin aktual të shërbimeve, si dhe për ndërlikimet e mundshme, duke përfshirë këtu rreziqet dhe përfitimet nga hyrja në marrëdhënie me një ofrues të ri shërbimesh.
- (b) Në qoftë se klienti ka marrë shërbime nga një agjenci apo nga ndonjë tjetër punonjës social, punonjësit socialë duhet të diskutojnë me klientin nëse është në interes të këtij të fundit që punonjësit socialë të konsultohen me ofruesin e tij të mëparshëm të shërbimeve.

3.12 Administrimi

- (a) Punonjësit socialë administratorë duhet të shfrytëzojnë burimet brenda dhe jashtë agjencisë me qëllim që të plotësojnë nevojat e klientëve.
- (b) Punonjësit socialë duhet të mbështesin ato procedura, për shfrytëzimin e burimeve që janë të hapura e të drejta. Këto procedura duhet të jenë jodiskriminuese, të bazuara mbi parime të përshtatshme dhe të qëndrueshme.
- (c) Punonjësit socialë administratorë duhet të ndërmarrin hapa të përgjegjshëm, me qëllim që agjencia e duhur të sigurojë supervizim të përshtatshëm e të vazhdueshëm të stafit.
- (d) Punonjësit socialë administratorë duhet të ndërmarrin hapa të përgjegjshëm për të siguruar që mjedisi i punës për të cilin ata janë përgjegjës, të jetë në pajtim me Kodin e Etikës. Punonjësit socialë administratorë duhet të ndërmarrin hapa të përgjegjshëm për të eliminuar çdo situatë në organizatën e tyre që dhunon, ndërhysh dhe inkurajon papajtueshmërinë me Kodin.

3.08 Edukimi dhe Zhvillimi i Mëtejshëm i Stafit.

Punonjësit socialë administratorë dhe supervizorë duhet të ndërmarrin hapa të përgjegjshëm për të siguruar një edukim të vazhdueshëm dhe zhvillim të stafit, për të cilin ata janë përgjegjës. Edukimi i vazhdueshëm dhe zhvillimi i stafit duhet të synojnë të japin njohuritë aktuale dhe zhvillimet e fundit në lidhje me praktikën e profesionit dhe etikën e punës sociale.

3.09 Detyrimet ndaj punëdhënësve

- (a) Punonjësit socialë në përgjithësi duhet të zbatojnë detyrat e dhëna nga punëdhënësit dhe organizata punëdhënëse.
- (b) Punonjësit socialë duhet të punojnë për të përmirësuar politikën, procedurat e agjencive punëdhënëse dhe për të rritur eficiencën dhe efektivitetin e shërbimeve të tyre.
- (c) Punonjësit socialë duhet të ndërmarrin hapa të përgjegjshëm për të siguruar që punëdhënësit të jenë në dijeni të detyrimeve etike të punonjësit social dhe ndërhyrjes së këtyre detyrimeve në praktikën e punës sociale.
- (d) Punonjësit socialë nuk duhet të lejojnë që politikën, procedurat, rregulloret ose urdhrat administrative të organizatës punëdhënëse të ndërhyjnë në praktikimin etik të punës sociale. Punonjësit socialë duhet të ndërmarrin hapa të përgjegjshëm për t'u siguruar që praktikën e organizatës së tyre punëdhënëse t'i qëndrojnë Kodit Etik të Punës Sociale.
- (e) Punonjësit socialë duhet të veprojnë për të parandaluar dhe eliminuar diskriminimin në vendin e punës dhe në praktikën e politikës së punësimit.
- (f) Punonjësit socialë duhet të pranojnë vendosjen e studentëve pranë organizatës, vetëm në rastet kur organizata ushtron praktika të drejta për personelin.
- (g) Punonjësit socialë duhet të jenë administratorë të kujdesshëm të burimeve të organizatës së tyre punëdhënëse duke i ruajtur me zgjuarsi fondet dhe duke mos i përdorur ato për qëllime jo të drejta.

3.10 Mosmarrëveshjet në menaxhimin e punës.

- (a) Punonjësit socialë mund të angazhohen në veprime të organizuara, duke përfshirë këtu formimin dhe marrjen pjesë në unionet e punës, me qëllim përmirësimin e shërbimeve për klientët dhe kushtet e punës.
- (b) Veprimet e punonjësve socialë të cilat janë të përfshira në mosmarrëveshje për menaxhimin e punës si greva në vendin e punës apo veprime të tjera, duhet të udhëhiqen nga vlerat profesionale, parimet e standardet etike. Opinione të ndryshme, të arsyeshme ekzistojnë midis punonjësve socialë, përsa i përket detyrimit të tyre primar si profesionistë gjatë një greve kërcënuese në vendin e punës. Në këtë rast punonjësit socialë duhet të ekzaminojnë me kujdes çështjet përkatëse dhe ndikimet e mundshme mbi klientët përpara se të vendosin për një kurs të drejtë veprimi.

KREU 4-Përgjegjësitë Etike të Punonjësve Socialë si Profesionistë

4.01 Kompetencat/aftësië dhe shprehitë

- (a) Punonjësit socialë duhet të pranojnë përgjegjësitë apo vendin e punës vetëm mbi baza të aftësive të tyre ekzistuese apo qëllimeve për të arritur kompetencat e nevojshme.
- (b) Punonjësit socialë duhet të përpiqen t'i qëndrojnë kompetent përmbushjes së funksioneve dhe praktikave profesionale. Punonjësit socialë në mënyrë të vazhdueshme duhet të rishikojnë literaturën profesionale dhe të marrin pjesë në edukimin e vazhdueshëm në lidhje me praktikën dhe etikën e punës sociale.
- (c) Punonjësit socialë duhet ta bazojnë praktikën mbi njohuritë e provuara tashmë, duke përfshirë këtu njohuritë me baza empirike, në përshtatje me punën sociale dhe etikën e punës sociale.

4.02 Diskriminimi

Punonjësit socialë nuk duhet të praktikojnë, falin, lehtësojnë apo të bashkëpunojnë në ndonjë formë diskriminimi mbi baza të gjinisë, racës, etnicitetit, origjinës, ngjyrës, orientimit seksual, moshës, statusit martesor, bindjeve politike, fesë, aftësisë së kufizuar mendore apo fizike.

4.03 Sjellja personale

Punonjësit socialë nuk duhet të lejojnë që sjellja e tyre personale të ndërhyjë në aktivitetin e tyre për të përmbushur përgjegjësitë profesionale.

4.07 Mashtrimi dhe Pandershmëria

Punonjësit socialë nuk duhet të marrin pjesë, të falin apo të bashkëpunojnë me pandershmërinë dhe mashtrimin.

4.05 Pengesat apo Vështirësitë

- (a) Punonjësit socialë nuk duhet të lejojnë që problemet e tyre personale, shqetësimi psikologjik, problemet ligjore, përdorimi i substancave, apo vështirësitë e shëndetit mendor, të ndikojnë apo të rrezikojnë interesat më të larta të personave ndaj të cilëve ata kanë përgjegjësi profesionale.
- (b) Punonjësit socialë, të cilëve problemet personale, shqetësimet psikologjike, problemet ligjore, përdorimi i substancave apo vështirësitë e shëndetit mendor u ndikojnë në gjykimin dhe ekzekutimin profesional duhet menjëherë të konsultohen dhe të ndërmarrin masat e duhura për rehabilitimin e tyre duke kërkuar ndihmë profesionale, përshtatur ngarkesën e punës, përfunduar praktikën, gjithnjë duke marrë hapa të nevojshëm për të mbrojtur klientët dhe të tjerët.

4.06 Përfaqësimi dhe prezantimi

- (a) Punonjësit socialë duhet të bëjnë dallime të qarta midis deklaratave të bëra dhe veprimeve të ndërmarra si individ privat apo si përfaqësues të profesionit të punës sociale, të organizatës profesionale të punës sociale dhe të agjencisë punëdhënëse punësuese të punonjësve socialë.
- (b) Punonjësit socialë të cilët flasin në emër të organizatave profesionale të punës sociale duhet që në mënyrë korrekte të prezantojnë pozicionet zyrtare dhe të autorizuar të këtyre organizatave.
- (c) Punonjësit socialë duhet të sigurohen që prezantimi i tyre tek klientët, agjencitë, publikimi i kualifikimeve të tyre profesionale, kredencialet, arsimit, kompetencat, shërbimet që ka ofruar apo rezultatet që do të arrijë, të paraqiten në mënyrë të saktë. Punonjësit socialë duhet të pretendojnë prezantimin e aftësive profesionale që ata aktualisht zotërojnë dhe të ndërmarrin hapat e duhura për të korrigjuar ndonjë pasaktësi apo keqprezantim të aftësive të tyre.

4.07 Tërheqja

- (a) Punonjësit socialë nuk duhet të përfshihen në kërkesat pa bazë të klientëve të mundshëm të cilët për shkak të rrethanave të tyre janë të pazotë të shmangin influencën, manipulimin dhe detyrimin.
- (b) Punonjësit socialë nuk duhet të kërkojnë dëshmi mbështetëse nga klientët aktual apo nga persona të tjerë të cilët për shkak të rrethanave ku ndodhen janë të pazotë të shmangin influencat.

4.08 Pranimi i Meritave

- (a) Punonjësit socialë duhet të marrin vetëm përgjegjësinë, autoritetin dhe autorësinë për punën që kanë kryer realisht aktualisht dhe për të cilën kanë kontribuar.
- (b) Punonjësit socialë duhet të pranojnë me ndershmëri punën dhe kontributet e arritura nga të tjerët.

KREU 5-Përgjegjësitë Etike të Punonjësve Socialë ndaj Profesionit të Punës Sociale.

5.01 Integriteti i Profesionit

- (a) Punonjësit socialë duhet të punojnë për ruajtjen dhe promovimin e standardeve të larta të praktikës.
- (b) Punonjësit socialë duhet të mbajnë lart dhe të përmirësojnë vlerat, etikën, njohuritë dhe misionin e profesionit. Punonjësit socialë duhet të mbrojnë, të shtojnë dhe të përmirësojnë integritetin e profesionit nëpërmjet studimit dhe kërkimit të përshtatshëm, diskutimeve aktive dhe kritikizmit përgjegjës të profesionit.
- (c) Punonjësit socialë duhet të kontribuojnë me kohën dhe ekspertizën profesionale në aktivitetet që promovojnë respekt për vlerat, integritetin dhe kompetencën e profesionit të punës sociale. Këto aktivitete mund të përfshijnë dhënien e mësimit, punën kërkimore, konsultimin, shërbimin, dëshminë legislative, paraqitjen në komunitet dhe pjesëmarrjen në organizatat profesionale.
- (d) Punonjësit socialë duhet të kontribuojnë në njohuritë bazë të punës sociale dhe të ndajnë me kolegët njohuritë e tyre në lidhje me praktikën, kërkimin dhe etikën. Punonjësit socialë duhet të kërkojnë të kontribuojnë në literaturën profesionale dhe të ndajnë njohuritë e tyre në takimet profesionale dhe nëpër konferenca.
- (e) Punonjësit socialë duhet të veprojnë për të parandaluar praktikat e paautorizuara dhe të pakualifikuara të punës sociale.

5.02 Vlerësimi dhe Kërkimi

- (a) Punonjësit socialë duhet të monitorojnë dhe vlerësojnë politikat, zbatimin e programeve dhe ndërhyrjet në praktikë.
- (b) Punonjësit socialë duhet të promovojnë dhe të lehtësojnë vlerësimin dhe kërkimin për të kontribuar në zhvillimin e njohurive.
- (c) Punonjësit socialë në mënyrë kritike duhet të ekzaminojnë dhe të jenë në kontakt me njohuritë e reja të Punës Sociale si dhe të përdorin në mënyrë të plotë evidencat vlerësuese dhe kërkimore në praktikën e tyre profesionale.
- (d) Punonjësit socialë të angazhuar në vlerësim apo kërkim duhet të marrin në konsideratë pasojat e mundshme dhe duhet të ndjekin direktivat e zhvilluara për mbrojtjen e pjesëmarrësve në vlerësim dhe kërkim. Ata duhet gjithashtu të konsultohen me bordet institucionale të rishikimit.
- (e) Punonjësit socialë të angazhuar në vlerësim apo kërkim duhet të marrin kur është e përshtatshme miratimin e shkruar dhe vullnetar të pjesëmarrësve, pa nënkuptuar ndonjë deprivim apo dënim kur ata refuzojnë të marrin pjesë, duke vlerësuar mirëqenien, privatësinë dhe dinjitetin e tyre. *Miratimi i informuar* duhet të përfshijë informacionin rreth natyrës, gjerësisë, kohëzgjatjes së pjesëmarrjes së kërkuar si dhe njohjen me rreziqet dhe përfitimet e pjesëmarrësve në kërkim.

- (f) Kur pjesëmarrësit në vlerësim apo kërkim janë të paaftë të japin miratimin, punonjësit socialë duhet t'u japin atyre një informacion të përshtatshëm për ta, në mënyrë që të sigurojnë miratimin e tyre deri në shkallën që ata mund ta japin dhe më pas duhet të marrin miratimin e shkruar nga përfaqësuesi i tyre.
- (g) Punonjësit socialë nuk duhet kurrë të projektojnë apo drejtojnë vlerësime, kërkime që nuk kanë në bazë procedurat miratuese, forma të tilla si vëzhgimet natyrale, kërkimet arkivore si dhe të gjitha procedurat alternative, sado efektive dhe me të ardhme shkencore që janë, në qoftë se mënjanojnë procedurën e miratimit janë të pazbatueshme.
- (h) Punonjësit socialë duhet të informojnë pjesëmarrësit në kërkim mbi të drejtën e tyre, për t'u tërhequr nga vlerësimi dhe kërkimi, në çdo kohë dhe pa asnjë pasojë.
- (i) Punonjësit socialë duhet të ndërmarrin hapa të përshtatshëm për të siguruar që pjesëmarrësit në vlerësim dhe kërkim të kenë të drejtë për të përfituar nga shërbimet mbështetëse.
- (j) Punonjësit socialë të përfshirë në vlerësim dhe kërkim duhet të mbrojnë pjesëmarrësit nga vuajtjet e pajustificuara fizike e mendore, dëmtimi, rreziku dhe deprivimi.
- (k) Punonjësit socialë të angazhuar në vlerësimin e shërbimeve duhet të diskutojnë informacionin e mbledhur vetëm për qëllime profesionale dhe me persona të interesuar profesionalisht për këtë informacion.
- (l) Punonjësit socialë të angazhuar në vlerësim apo kërkim duhet të ruajnë anonimitetin apo konfidencialitetin e pjesëmarrësve dhe të të dhënave të marra prej tyre. Punonjësit socialë duhet t'i informojnë pjesëmarrësit për ndonjë kufizim të konfidencialitetit, masat që do të merren për të siguruar këtë konfidencialitet si dhe rastet kur ndonjë nga dokumentacionet që përmban të dhënat kërkimore do të shkatërrohet.
- (m) Punonjësit socialë të cilët raportojnë rezultatet e vlerësimit dhe të kërkimit duhet të mbrojnë konfidencialitetin e pjesëmarrësve në vlerësim apo kërkim duke përjashtuar nga raportimi informacionin identifikues, me përjashtim të rasteve kur është dhënë miratimi.
- (n) Punonjësit socialë duhet të raportojnë rezultatet e vlerësimit dhe të kërkimit në mënyrë të përpiktë. Ata nuk duhet të falsifikojnë rezultatet dhe duhet të ndërmarrin hapa për të rregulluar gabimet e gjetura më vonë në të dhënat e publikuara duke përdorur metodat standarde të publikimit.
- (o) Punonjësit socialë të përfshirë në vlerësim apo punë kërkimore duhet të jenë të kujdesshëm dhe të mënjanojnë konfliktet e interesave dhe dyzimin e marrëdhënieve me pjesëmarrësit. Ata duhet të informojnë pjesëmarrësit kur një konflikt i vërtetë apo i mundshëm interesash po shfaqet dhe duhet të ndërmarrin hapat e nevojshme për zgjidhjen e çështjes duke parë interesat e pjesëmarrësve me përparësi.
- (p) Punonjësit socialë duhet të edukojnë vetveten, studentët dhe kolegët e tyre me praktikatat përgjegjëse të kërkimit.

KREU 6-Përgjegjësitë Etike të Punonjësve Socialë ndaj Shoqërisë në Tërësi

6.01 Mirëqenia Sociale

Punonjësit socialë duhet të promovojnë mirëqenien sociale në përgjithësi nga nivelet lokale deri tek ato globale, zhvillimin e individëve, komuniteteve dhe mjediseve të tyre. Punonjësit socialë duhet të mbështesin kushtet e jetesës për përmbushjen e nevojave bazë të njeriut dhe duhet të promovojnë vlerat sociale, ekonomike, kulturore si dhe institucionet që janë të nevojshëm për vendosjen e drejtësisë sociale.

6.04 Pjesëmarrja Publike

Punonjësit socialë duhet të lehtësojnë *pjesëmarrjen e informuar* të publikut në ndërtimin e politikave sociale dhe të institucioneve.

6.03 Emergjencat Publike

Punonjësit socialë, gjatë emergjencave publike, duhet të ofrojnë në masën më të madhe të mundshme shërbimet e duhura profesionale.

6.04 Veprimi Social dhe Politik

- (a) Punonjësit socialë duhet të përfshihen në veprime sociale dhe politike, që synojnë t'u sigurojnë të gjithë njerëzve të drejta të barabarta për mbështetje, punësim, shërbime, mundësi për plotësimin e nevojave njerëzore bazë e zhvillim maksimal. Punonjësit socialë duhet të jenë të ndërgjegjshëm për ndikimin e arenës politike në praktikën e profesionit, dhe po kështu duhet të mbrojnë ndryshimet në politika dhe legjislacion për përmirësimin e kushteve sociale, plotësimin e nevojave njerëzore dhe promovimin e drejtësisë sociale.
- (b) Punonjësit socialë duhet të zgjerojnë zgjedhjet dhe shanset për të gjithë njerëzit, në veçanti për njerëzit dhe grupet vulnerabël, të përjashtuar nga jeta sociale e të shfrytëzuar.
- (c) Punonjësit socialë duhet të promovojnë ato kushte të cilat inkurajojnë respektin për diversitetin social-kulturor. Punonjësit socialë duhet të nxisin politika dhe praktika që respektojnë ndryshimin, mbështesin zgjerimin e njohurive dhe burimeve kulturore, mbrojnë programe dhe institucione që tregojnë kompetencë kulturore, promovojnë politika që mbrojnë të drejtat e vërtetojnë barazi dhe drejtësi sociale për të gjithë njerëzit.
- (d) Punonjësit socialë duhet të veprojnë në atë mënyrë që të parandalojnë dhe eliminojnë dominimin, shfrytëzimin dhe diskriminimin e një personi, grupi apo komuniteti, klase bazuar në gjininë, racën, etnicitet, origjinë kombëtare, ngjyrë, orientim seksual, moshë, status martesor, bindje politike, fe, ose aftësi të kufizuar mendore apo fizike.